



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 26.03.2019

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI - SHQIPËRI, ALOKIMET E VITIT 2017”

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, mori në shqyrtim projektligjin “Për Ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2017”.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm z. Sokol Dedja, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, si edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi i këtij projektligji është të miratojë propozimin e projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar **IPA II, Mali i Zi - Shqipëri, alokimet e vitit 2017**. Programi i bashkëpunimit Mali i Zi - Shqipëri ka për qëllim

kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit Evropian nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej një 1.19 milion euro për të dyja vendet, si edhe bashkëfinancim kombëtar të të dyja shteteve bashkërisht në shumën 210 mijë euro. Si rrjedhojë, buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2017 arrin vlerën 1.4 milion euro.

Përfitues të këtij programi do të jenë zonat si Shkodra, Lezha dhe Rrethi i Tropojës. Programi do të fokusohet në nxitjen e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore e natyrore, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e punësimit si edhe të lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale e kulturore përtej kufirit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financimi do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë, sipas prioriteteve të përcaktuara në program, duke u mundësuar në këtë mënyrë aktorëve rajonalë dhe vendorë nga të dyja vendet të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme e një efekt të matshëm për sektorin social-ekonomik.

III. PËRFUNDIM

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relator vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në Komision.

RELATORI

KRYETARI

JURGIS ÇYRBJA

ULSI MANJA